



**BULETINI PERIODIK I  
PRAKTIKËS GJYQËSORE  
PERIODIČNI BILTEN  
SUĐSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

**JANAR-MARS  
JANUAR-MART  
2022**

**I**

## **Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese** (Janar – Mars 2022)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmbanpërmbledhjen e aktgjykimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Me qëllimin për ta bërë sa më të qartë për lexuesit natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimet dhe aktvendimet janë klasifikuar sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në baza periodike dhe është përgatitur nga Sekretaria e Gjykatës vetëm për çështje informative.

Tekstet e plota të aktgjykimeve dhe të aktvendimeve të përfshira në këtë Buletin janë pu blikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe mund t'i gjeni të publikuara edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohemi në ueb-faqen e Gjykatës: [www.gjk-s.org/publication\\_category/buletini-periodik](http://www.gjk-s.org/publication_category/buletini-periodik)

**Vërejtje:** Kushdo që dëshiron të kopjoj, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

## **Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda** (Januar – Mart 2022. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

Kako bi se čitaocima učinila što jasnijom priroda odluka Ustavnog suda, presude i rešenja su klasifikovana prema navodima zasnovanim na određenim članovima Ustava Republike Kosovo.

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično, a Sekretarijat suda ga priprema samo u informativne svrhe.

Kompletni tekstovi presuda i rešenja sadržanih u ovom Biltenu objavljeni su u Službenom listu Republike Kosovo, a mogu se naći i na internet stranici Ustavnog suda: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internet stranici Suda:

[www.gjk-ks.org/sr/publication\\_category/periodicni-bilten/](http://www.gjk-ks.org/sr/publication_category/periodicni-bilten/)

**Napomena:** Svako ko želi da kopira, prevede ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

"Perandori Justinian", nr. 44. 10 000 Prishtinë  
Tel: +383 (0) 38 60 61 62  
Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576  
Fax: +383(0) 38 60 61 70  
Email: [gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org](mailto:gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org)  
©Gjykata Kushtetuese 2022

Tabela e përmbajtjes / Pregled sadržaja

**I - Neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

**I - Član 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]**

**(i) E drejta për “qasje në gjykatë”**

**(i) Pravo na “pristup sudu”**

- Hedhja poshtë nga Gjykata Supreme e revizionit të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, për shkak të mungesës së autorizimit për përfaqësuesit e parashtruesve të kërkesës, pa iu dhënë mundësi që të sqarohen lidhur me çështjen e përfaqësimit të tyre nga avokati ose mundësi që avokati të sjellë brenda një afati të caktuar dëshminë e përfaqësimit të parashtruesve të kërkesës, përbën shkelje të së drejtës së “qasjes në gjykatë” si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstim e mëtejme: KEDNJ): - shkelje e të drejtave kushtetuese.
- To što je Vrhovni sud odbacio reviziju koju su podneli podnosioci zahteva zbog nedostatka punomoćja za zastupnike podnosilaca zahteva, ne pružajući im mogućnost da se izjasne po pitanju njihovog zastupanja od strane advokata ili mogućnost da advokat u određenom roku dostavi dokaz o zastupanju podnosilaca zahteva, predstavlja povredu prava na “pristup sudu” kao sastavni delo pravičnog suđenja zagarantovanog članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima (u daljem tekstu: EKLJP): - povreda ustavnih prava.

*KI182/20, Parashtrues: Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi, kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev. 54/2020] të 6 korrikut 2020 .....6*

*KI182/20, Podnosioci: Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi i Sabrije Zhubi, zahtev za ocenu ustavnosti rešenja [Rev. 54/2020] Vrhovnog suda od 6. jula 2020. godine.....6*

**(ii) E drejta për një vendim të arsyetuar**

**(ii) Pravo na obrazloženu odluku**

- Mosdhënia e përgjigjeve të qarta dhe të plota përkitazi me pretendimet thelbësore dhe përcaktueset të ngritura nga parashtruesja e kërkesës, më konkretisht mosarsyetimi nga gjykatat e rregullta (i) nëse ka pasur trajtim dhe vendimmarrje divergjente të Gjykatës Themelore në rrethanat e ngjashme faktike dhe juridike; dhe (ii) nëse përgjigja është pozitive, a ekzistojnë justifikime të arsyeshme për një devijim të tillë të praktikës gjyqësore, rezultojnë shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: - shkelje e të drejtave kushtetuese.
- To što nisu pruženi jasni i potpuni odgovori u vezi sa bitnim i odlučujućim navodima koje je iznela podnositeljka zahteva, konkretnije to što redovni sudovi nisu obrazložili (i) da li je bilo različitog tretiranja i odlučivanja Osnovnog suda u sličnim činjeničnim i pravnim okolnostima; i (ii) ako je odgovor pozitivan, da li postoje razumna opravdanja za takvo odstupanje od sudske prakse, ima za rezultat povredu prava na obrazloženu odluku, kao sastavni delo prava na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovanog članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP: - povreda ustavnih prava.

*KI49/20, Parashtruese: Shehide Muhadri, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac. nr. 530/2016] të 10 dhjetorit 2019.....9*

*KI49/20, Podnositeljka: Shehide Muhadri, zahtev za ocenu ustavnosti presude [Ac. br. 530/2016] Apelacionog suda Kosova od 10. decembra 2019. godine.....9*

**(iii) E drejta për një vendim të arsyetuar**

**(iii) Pravo na obrazloženu odluku**

- Gykatat me juridiksion apeli në miratimin e vendimi të një instance më të ulët, jo detyrimisht duhet dhënë sqarime lidhur me secilin argument të palës, megjithatë, të njëjtat duhet të tregojnë “konsideratë të mjaftueshme” duke adresuar pretendimet e palëve të cilat janë thelbësore dhe/ose përcaktuese për meritat e një rasti. Për më tepër, arsyetimi i një vendimi për pezullim të vendimit deri në zgjidhjen meritore të çështjes, duke përfshirë edhe atë të gjykatave me juridiksion apeli, vetëm duke përshkruar dispozita ligjore dhe pa dhënë asnjë arsyetim lidhur me plotësimin e kriterëve qartë të përcaktuara në ligjet e aplikueshme rezultojnë në shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: - *shkelje e të drejtave kushtetuese*.
- Sudovi sa apelacionom nadležnošću kada potvrđuju odluku niže instance ne moraju nužno izneti objašnjenja o svakom argumentu stranke, već isti moraju da ispolje “dužnu pažnju” odgovarajući na navode stranaka koji su bitni i/ili odlučujući za meritum određenog predmeta. Pored toga, obrazloženje odluke o suspenziji odluke do meritornog rešavanja predmeta, uključujući i onu sudova sa apelacionom nadležnošću, samo opisujući zakonske odredbe i ne pružajući nikakvo obrazloženje u vezi sa ispunjenjem kriterijuma koji su jasno utvrđeni u primenljivim zakonima, dovodi do povrede prava na obrazloženu odluku, kao sastavnog dela prava na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovanog članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP: - *povreda ustavnih prava*.

*KI75/21, Parashtrues: “Abrazen LLC”, “Energy Development Group Kosova LLC”, “Alsi & Co. Kosovë LLC” dhe “Building Construction LLC”, V Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr.44/2020 të Gjykatës Supreme të 23 korrikut 2020.....12*

*KI75/21, Podnosilac: “Abrazen LLC”, “Energy Development Group Kosova LLC”, “Alsi & Co. Kosovë LLC” i “Building Construction LLC”, ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda ARJ-UZVP. br. 44/2020 od 23. jula 2020. godine.....12*

**II- Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

**II- Član 24 [Jednakost pred zakonom]**

**(i) Barazia para ligjit**

**(i) Jednakost pred zakonom**

- Dallimi në trajtim në mes personave në “situata analoge ose relativisht të ngjashme”, rezultojnë në diskriminim në kundërshtim me të drejtën për barazi para ligjit, që mund të arsyetohet vetëm nëse plotësohen, në mënyrë kumulative, kushtet në vijim: (a) nëse dallim në trajtim është i “përcaktuar në ligj”; (b) ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (c) është “proporcional”. Konsumatorët e energjisë elektrike në të gjitha komunat e Kosovës janë në “situata analoge ose relativisht të ngjashme”, megjithatë mbulimi i energjisë elektrike vetëm për banorët e disa komunave të Kosovës përmes vendimit të kontestuar, në rrethanat e rastit, ishte (a) “përcaktuar me ligj”; (b) kishte “qëllim legjitim”, mes tjerash: (i) ushtrimin e sovranitetit në sistemin elektroenergetik me të gjitha të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Marrëveshjen e Kycjes me ENTSO-E; (ii) ruajtjen e pavarësisë energjetike të Republikës së Kosovës; (iii) garantimin e furnizimit me energji elektrike në të gjithë territorin e Kosovës; dhe (iv) ruajtjen dhe fuqizimin e statusit të KOSTT-it në mekanizmin ndërkombëtar; si dhe (c) ishte “proporcional” pasi ishte i karakterit të përkohshëm dhe Qeveria obligohej që brenda afatit gjashtë (6) mujor, të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit të të gjithë banorëve të Kosovës: - jo shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Razlika u tretiranju između osoba u “analognim ili relativno sličnim situacijama”, dovodi do diskriminacije u suprotnosti sa pravom na jednakost pred zakonom, koja se može opravdati samo ako su kumulativno ispunjeni sledeći uslovi: (a) da je razlika u tretiranju propisana zakonom; (b) da teži legitimnom cilju; i (c) da je srazmerna. Potrošači električne energije u svim opštinama na Kosovu se nalaze u “analognim ili relativno sličnim situacijama”, međutim, pokrivanje električne energije samo za stanovnike nekoliko opština na Kosovu kroz osporenu odluku, u okolnostima slučaja, je (a) bilo “propisano zakonom”; (b) imalo legitiman cilj, između ostalog: (i) vršenje su-



vereniteta u elektroenergetskom sistemu sa svim pravima i obavezama utvrđenim Sporazumom o povezivanju sa ENTSO-E; (ii) očuvanje energetske nezavisnosti Republike Kosovo; (iii) garantovanje snabdevanja električnom energijom na celoj teritoriji Kosova; i (iv) očuvanje i jačanje statusa KOSTT-a u međunarodnom mehanizmu; i (c) bilo je “srazmerno” jer je bilo privremenog karaktera, a Vlada je obavezana da u roku od šest (6) meseci osigura čitav proces uvođenja u sistem fakturisanja svih stanovnika Kosova: - nema povrede ustavnih prava.

*KO93/21, Parashtrues, Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.08-R-01 të 6 majit 2021.....16*

*KO93/21, Podnosilac: Blerta Deliu-Kodra i 12 drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo, ocena ustavnosti Preporuka Skupštine Republike Kosovo br. 08-R-01 od 6. maja 2021. godine.....16*

### III- Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

#### III- Çlan 36 [Pravo na privatnost]

##### (i) *E drejta për jetë private*

##### (i) *Pravo na privatni život*

- Autorizimi masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit rezulton në “ndërhurje” në të drejtën për “jetë private” dhe “korrespondencë”, e cila mund të arsyetohet vetën nëse plotësohen, në mënyrë kumulative, kushtet në vijim: (i) kufizimi të jetë “i përcaktuar në ligj”; (ii) të ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) nëse është “proporcionale”. Urdhri i një gjykate që autorizon retroaktivisht masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit, më specifiku autorizimi i leximit të mesazheve SMS në mënyrë retroaktive, nuk është përcaktuar me Kodin e Porcedurës Penale, andaj kjo rezultoi në shkeljen e të drejtës së privatësisë së parashtrueses së kërkesës, në kundërshtim me garantitë e nenit 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së: - *shkelje e të drejtave kushtetuese*.
- Ovlavshenje skriveh i tehnikih mera posmatranja i istrage rezultira “mešanjem” u pravo na “privatni život” i “prepisku”, koje može biti opravdano samo ako su kumulativno ispunjeni sledeći uslovi: (i) da je ograničenje “propisano zakonom”; (ii) da teži “legitimnom cilju”; i (iii) da je “srazmerno”. Naredba suda koja retroaktivno ovlašćuje skrivene i tehničke mere posmatranja, specifično retroaktivno ovlašćenje čitanja SMS poruka nije propisano Zakonikom o krivičnom postupku, što je dovelo do povrede prava na privatnost podnositeljke zahteva u suprotnosti sa garancijama iz člana 36. [Pravo na privatnost] Ustava u vezi sa članom 8. (Pravo na poštovanje privatnog i porodičnog života) EKLJP-a: - *povreda ustavnih prava*.

*KI113/21, Parashtrues i kërkesës: Bukuriye Haxhimurati, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 29/2021 të 13 prillit 2021.....28*

*KI113/21, Podnositeljka zahteva: Bukuriye Haxhimurati, ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova Pml. br. 29/2021 od 13. aprila 2021. godine .....28*

*Në vijim do të paraqitet përmbledhje më e detajuar e aktgjykimeve të lartcekura dhe të cilat janë publikuar nga Gjykata gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.*

*U nastavku ćemo predstaviti detaljniji sažetak gore navedenih presuda, a koje je Sud objavio u poslednja tri (3) meseca.*

Neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

***E drejta për “qasje në gjykatë”***

***KI182/20, Parashtruesit: Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi, kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev. 54/2020] të 6 korrikut 2020***

Hedhja poshtë nga Gjykata Supreme e revizionit të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, për shkak të mungesës së autorizimit për përfaqësuesit e parashtruesve të kërkesës, pa iu dhënë mundësi që të sqarohen lidhur me çështjen e përfaqësimit të tyre nga avokati ose mundësi që avokati të sjellë brenda një afati të caktuar dëshminë e përfaqësimit të parashtruesve të kërkesës, përbën shkelje të së drejtës së “qasjes në gjykatë” si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së: - *shkelje e të drejtave kushtetuese.*

***Faktet***

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurën kontestimore të iniciuar nga parashtruesit e kërkesës, fillimisht në Gjykatën Komunale në Prizren, kundër Komunës së Prizrenit, përmes së cilës kërkuan që të konstatohet se ata janë bashkëpronarë të një prone. Të gjithë parashtruesit e kërkesës, me autorizime individuale, autorizuan avokatin S.R., nga Prizreni, që t’i përfaqësojë ata në procedurën kontestimore, duke e autorizuar të njëjtin po ashtu që të mund t’i transferojë autorizimin një avokati tjetër. Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin përmes së cilit aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, vendim ky i cili më pas ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Qarkut në Prizren. Megjithatë, çështja ishte kthyer në rivendosje pas vendimit të Gjykatës Supreme, të nxjerrë sipas revizionit të Komunës së Prizrenit. Në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore në Prizren e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, vendim ky që u

Çlan 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

***Pravo na “pristup sudu”***

***KI182/20, Podnosioci: Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi i Sabrije Zhubi, zahtev za ocenu ustavnosti rešenja [Rev. 54/2020] Vrhovnog suda od 6. jula 2020. godine***

To što je Vrhovni sud odbacio reviziju koju su podneli podnosioci zahteva zbog nedostatka punomoćja za zastupnike podnosilaca zahteva, ne pružajući im mogućnost da se izjasne po pitanju njihovog zastupanja od strane advokata ili mogućnost da advokat u određenom roku dostavi dokaz o zastupanju podnosilaca zahteva, predstavlja povredu prava na “pristup sudu” kao sastavnog dela pravičnog suđenja zagarantovanog članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: - *povreda ustavnih prava.*

***Činjenice***

Okolnosti konkretnog slučaja se tiču parničnog postupka koji su podnosioci zahteva prvenstveno pokrenuli pred Opštinskim sudom u Prizrenu, protiv opštine Prizren, u kome su tražili, da se utvrdi da su oni suvlasnici jedne imovine. Svi podnosioci zahteva su pojedinačnim ovlašćenjima ovlastili advokata S.R., iz Prizrena, da ih zastupa u parničnom postupku, ovlašćujući istog da može ovlašćenje da prenese i na nekog drugog advokata. Opštinski sud je doneo presudu kojom je prihvatio tužbeni zahtev podnosilaca zahteva, a ovu odluku je potvrdio i Okružni sudu Prizrenu. Međutim, pitanje je vraćeno na ponovno odlučivanje nakon odluke Vrhovnog suda, donete po reviziji opštine Prizren. U ponovljenom postupku Osnovni sud u Prizrenu je odbio tužbeni zahtev podnosilaca, a ova odluka je potvrđena i od strane Apelacionog suda. Nakon donošenja presude Apelacionog suda, advokat S.R., shodno klauzuli iz ovlašćenja, izvršio je transfer prava zastupanja podnosilaca zahteva na drugog advokata E.G. Kao novi zastupnik podnosilaca zahteva, advokat

vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit. Pas nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, avokati S.R., në bazë të klauzolës së autorizimit i kishte transferuar të drejtën e përfaqësimit të parashtruesve të kërkesës avokatit E.G. Si përfaqësues i ri i parashtruesve, avokati E.G., parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, e hodhi poshtë revizionin, duke deklaruar se në shkresat e lëndës nuk ekziston autorizimi me të cilën parashtruesit e kërkesës autorizuan avokatin E.G., për t'i përfaqësuar në Gjykatën Supreme.

#### *Ankesa e parashtruesve të kërkesës*

Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës pretenduan se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, ata pretenduan se duke hedhur poshtë si të palejuar revizionin e tyre, edhe me supozimin se nuk kishte autorizim në shkresat e lëndës për avokatin E.G., Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim me garantitë procedurale për qasje në gjykatë të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksuan se bazuar në paragrafin 2 të nenit 93 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), gjykata mund të lejojë që veprimet në procedurë për palën përkohësisht t'i kryejë personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do ta urdhërojë atë që brenda afatit të caktuar ta paraqesë prokurën ose aprovimin e palës për veprimet procedurale të kryera. Përkundër garancive kushtetuese dhe ligjore, Gjykata Supreme, thjeshtë kishte hedhur poshtë revizionin e tyre, pa u kërkuar parashtruesëve sqarimin/dorëzimin e autorizimit brenda një afati të caktuar dhe pa u dhënë mundësinë që të deklarohen lidhur me statusin juridik të avokatit E.G., i cili parashtroi

E.G, podneo je zahtev za reviziju Vrhovnog suda. Potonji je odbacio reviziju, navodeći da u spisima predmeta ne postoji punomoćje kojim su podnosioci zahteva ovlastili advokata E.G., da ih zastupa pred Vrhovnim sudom.

#### *Žalba podnosilaca zahteva*

Podnosioci zahteva su pred Sudom naveli da je rešenje Vrhovnog suda doneto uz povredu njihovih prava i sloboda zagarantovanih članovima 21 [Opšta načela], 23 [Ljudsko dostojanstvo], 24 [Jednakost pred zakonom], 31 i 54 [Sudska zaštita prava] Ustava Republike Kosovo. U tom kontekstu, oni su naveli da je odbacivanjem njihove revizije kao nedozvoljene, čak i pod pretpostavkom da u spisima predmeta nema ovlašćenja za advokata E.G., Vrhovni sud postupio suprotno proceduralnim garancijama pristupa sudu predviđenim članom 31. Ustava. u vezi sa članom 6. EKLJP-a. Dalje, podnosioci zahteva su naveli da na osnovu stava 2. člana 93. Zakona br. 03/L-006 o parničnom postupku (u daljem tekstu: ZPP), sud može dozvoliti da radnje u postupku za stranku privremeno izvrši lice koje nije dostavilo punomoćje, ali će mu istovremeno naložiti da u određenom roku podnese punomoćje ili odobrenje stranke za izvršene proceduralne radnje. Uprkos ustavnim i zakonskim garancijama, Vrhovni sud je jednostavno odbio njihovu reviziju, ne zahtevajući od podnosilaca zahteva da razjasne/podnesu ovlašćenje u određenom roku i ne dajući im mogućnost da se izjasne o pravnom statusu advokata E.G., koji je podneo zahtev u njihovo ime.

#### *Nalazi Suda*

Razmatrajući navode podnosilaca zahteva o povredi njihovih prava u kontekstu prava na "pristup sudu", kao jednog od osnovnih principa pravičnog suđenja zagarantovanog članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a, Sud je prvo razradio, a zatim primenio, načela svoje sudske prakse i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava (u daljem tekstu: ESLJP). Na osnovu ovih načela, pravo na "pristup sudu" ne podrazumeva

kërkesën për revizion në emër të tyre.

### Gjetjet e Gjykatës

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e të drejtave të tyre, në kuadrin e të drejtës së “*qasjes në gjykatë*”, si një nga parimet kryesore për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht shtjelloi dhe më pas zbatoi parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ). Sipas këtyre parimeve, e drejta e “*qasjes në gjykatë*” nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individit duhet të ketë gjithashtu një mundësi “*të qartë dhe reale*” për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj dhe që rasti i tij/saj të trajtohet në merita.

Pas vlerësimit të të gjitha rrethanave në këtë rast, Gjykata theksoi se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e së drejtës së “*qasjes në gjykatë*” ishin të bazuara, për shkak se Gjykata Supreme, bazuar në garantitë kushtetuese por edhe në vet LPK-në, para hedhjes poshtë të revizionit në mënyrë krejtësisht formale, duhet t’u kishte dhënë mundësi parashtruesve të kërkesës që të sqarohen lidhur me çështjen e përfaqësimit të tyre nga avokati E.G., ose të jepej mundësia që avokati E.G. të sjellë brenda një afati të caktuar dëshminë e përfaqësimit të parashtruesve të kërkesës.

### Përfundimi

Bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktvendimi i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në kundërshtim me garantitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe rrjedhimisht e shpalli të njëjtin të pavlefshëm, duke e kthyer atë për rivendosje në Gjykatën Supreme.

samo pravo da se iniciraju postupci pred nekim sudom, već, da bi pravo na pristup sudu bilo efektivno, pojedinac treba da ima mogućnost koja je “*jasna i realna*” da bi osporio neku odluku koja povređuje njegovu/njena prava i da se njegov/njen slučaj razmotri u meritumu.

Nakon ocene svih okolnosti u ovom slučaju, Sud je istakao da su navodi podnosilaca zahteva o povredi prava na “*pristup sudu*” osnovani, zato što je Vrhovni sud, na osnovu kako ustavnih garancija, tako i na osnovu samog ZPP-a, pre odbacivanja revizije na potpuno formalan način, trebao da da mogućnost podnosiocima zahteva da se izjasne oko pitanja njihove zastupljenosti od strane advokata E.G., ili da se da mogućnost da advokat E.G., donese u određenom roku dokaz o zastupanju podnosioca zahteva.

### Zaključak

Zasnovano i na objašnjenjima datim u objavljenoj presudi, Sud je utvrdio da je rešenje Vrhovnog suda doneto u suprotnosti sa proceduralnim garancijama propisanim u članu 31. Ustava u vezi sa članom 6. EKLJP, pa je shodno tome, isto proglasio ništavim, vraćajući ga na ponovno odlučivanje pred Vrhovnim Sudom.



### **Neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

#### ***E drejta për një vendim të arsyetuar***

***KI49/20, Parashtruese: Shehide Muhadri, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac. nr. 530/2016], të 10 dhjetorit 2019***

Mosdhënia e përgjigjeve të qarta dhe të plota përkitazi me pretendimet thelbësore dhe përcaktuese të ngritura nga parashtruesja e kërkesës, më konkretisht mosarsyetimi nga gjykatat e rregullta (i) nëse ka pasur trajtim dhe vendimmarrje divergjente të Gjykatës Themelore në rrethanat e ngjashme faktike dhe juridike; dhe (ii) nëse përgjigja është pozitive, a ekzistojnë justifikime të arsyeshme për një devijim të tillë të praktikës gjyqësore, rezultojnë në shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: - *shkelje e të drejtave kushtetuese*

#### ***Faktet***

Rrethanat e rastin konkret ndërlidhen me të drejtën e pronësisë mbi një numër të parcelave të tokës, të cilat Komuna e Lipjanit i kishte blerë nga pronarët privat në vitet e 60-ta, me fondet e siguruara nga Fondi Ndërkombëtar për Refugjatët, Organizata e Kombeve të Bashkuara, me qëllim të vendosjes dhe integritimit të refugjatëve që kishin ardhur nga Shqipëria në Kosovë në vitet e 60-ta. Përkundër faktit se parcelat iu dhanë për shfrytëzim refugjatëve, në mesin e të cilëve ishte edhe parashtruesja e kërkesës, ato mbetën të regjistruara si pronë e Komunës së Lipjanit.

Parashtruesja e kërkesës dhe një grup i personave të tjerë kishin parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Lipjan, kundër Komunës së Lipjanit, përmes së cilës kërkuan vërtetimin e pronësisë mbi parcelat kontestuese, duke pretenduar se ata kanë qenë në posedim të ligjshëm të parcelave që nga viti 1969. Gjykata Komunale

### **Çlan 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]**

#### ***Pravo na obrazloženu odluku***

***KI49/20, Podnositeljka: Shehide Muhadri, zahtev za ocenu ustavnosti presude [Ac. br. 530/2016] Apelacionog suda Kosova od 10. decembra 2019. godine***

To što nisu pruženi jasni i potpuni odgovori u vezi sa bitnim i odlučujućim navodima koje je iznela podnositeljka zahteva, konkretnije to što redovni sudovi nisu obrazložili (i) da li je bilo različitog tretiranja i odlučivanja Osnovnog suda u sličnim činjeničnim i pravnim okolnostima; i (ii) ako je odgovor pozitivan, da li postoje razumna opravdanja za takvo odstupanje od sudske prakse, ima za rezultat povredu prava na obrazloženu odluku, kao sastavnog dela prava na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovanog članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP: - *povreda ustavnih prava*

#### ***Činjenice***

Okolnosti ovog slučaja se odnose na pravo svojine na jednom broju parcela koje je opština Lipljan 60-ih godina otkupila od privatnih vlasnika sredstvima Međunarodnog fonda za izbeglice Organizacije Ujedinjenih nacija u cilju nastanjivanja i integracije izbeglica koje su došle iz Albanije na Kosovo 60-ih godina. Uprkos činjenici da su parcele date na korišćenje izbeglicama, među kojima je bila i podnositeljka zahteva, one su ostale upisane kao vlasništvo opštine Lipljan.

Podnositeljka zahteva i grupa drugih lica su podneli tužbu Opštinskom sudu u Lipljanu protiv opštine Lipljan, kojom su tražili utvrđivanje svojine nad spornim parcelama, tvrdeći da su bili u zakonitom posedu parcela još od 1969. godine. Opštinski sud u Lipljanu je usvojio tužbu i doneo presudu kojom se priznaje pravo svojine tužiocima, uključujući i podnositeljku zahteva. Međutim, Apelacioni sud je, po žalbi opštine Lipljan, poništio presudu Osnovnog suda, vraćajući slučaj na prei-

në Lipjan aprovoi padinë dhe nxori Aktgjykimin përmes së cilit paditësve, përfshirë edhe parashtruesen e kërkesës, ua njohu të drejtën e pronësisë. Megjithatë, Gjykata e Apelit, pas ankesës së Komunës së Lipjanit e kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e kthyer çështjen në rivendosje. Në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore e refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe paditësve të tjerë, pasi vlerësoi që sipas legjislacionit në fuqi, e drejta e pronësisë në pronë shoqërore në asnjë rrethanë nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit. Paditësit, duke përfshirë edhe parashtruesen e kërkesës, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se Gjykata Themelore ka devijuar nga praktika e saj gjyqësore, pasi që në rrethana të ngjashme me paditës të tjerë, Gjykata Themelore kishte njohur të drejtën në pronë si pasojë e parashkrimit. Gjykata e Apelit refuzoi si të pabazuar pretendimet ankimore të parashtrueses së kërkesës, duke vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore. Duke kontestuar vendimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesja e kërkesës, përmes kërkesës KI145/18, kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar mes tjerash, shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Duke analizuar dhe shqyrtuar pretendimet e parashtrueses në kërkesën KI 145/18, në kontekst të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, Gjykata, përmes Aktgjykimit KI145/18 të 19 korrikut 2018, kishte arritur në përfundimin se, Gjykata e Apelit nuk i ishte përgjigjur pretendimit të parashtrueses së kërkesës për përkitazi me diskriminimin por edhe shmangien nga praktika gjyqësore e Gjykatës Themelore në rrethana të ngjashme juridike dhe faktike. Rrjedhimisht, Gjykata kishte konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes nenit

spitivanje. Osnovni sud je u ponovljenom postupku odbio tužbeni zahtev podnositeljke zahteva i drugih tužilaca, ocenivši da se prema važećim zakonima pravo svojine na društvenoj svojini ni u kom slučaju ne može steći na osnovu zastarelosti. Tužioc, uključujući i podnositeljku zahteva, uložili su žalbu Apelacionom sudu, navodeći da je Osnovni sud odstupio od svoje sudske prakse, jer je u sličnim okolnostima i drugim tužiocima, Osnovni sud priznao pravo na imovinu kao posledicu zastarelosti. Apelacioni sud je odbio, kao neosnovane, žalbene navode podnositeljke zahteva, potvrdivši odluku Osnovnog suda. Osvrtajući odluku Apelacionog suda, podnositeljka zahteva je zahtevom KI145/18 tražila od Ustavnog suda da oceni ustavnost presude Apelacionog suda, navodeći, između ostalog, povredu člana 24. i 31. Ustava Republike Kosovo u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) EKLJP-a.

Analizirajući i razmatrajući navode podnositeljke u zahtevu KI145/18 u kontekstu prava na obrazloženu sudske odluke, Sud je presudom KI145/18 od 19. jula 2018. godine zaključio da Apelacioni sud nije odgovorio na navod podnositeljke zahteva u vezi diskriminacije, ali i odstupanja od sudske prakse Osnovnog suda u sličnim pravnim i činjeničnim okolnostima. Shodno tome, Sud je utvrdio da je presuda Apelacionog suda doneta u suprotnosti sa procesnim garancijama utvrđenim u članu 31. Ustava u vezi sa članom 6. EKLJP-a i vratio predmet Apelacionom sudu na ponovno odlučivanje.

U ponovljenom postupku, Apelacioni sud je ponovo odbio tužbu podnositeljke zahteva. Apelacioni sud je u novoj odluci, između ostalog, istakao da (i) je tačno da se slučaj podnositeljke zahteva i drugi slučajevi na koje se ista poziva odnose na „*iste činjenične i pravne okolnosti*“; i (ii) ne može se smatrati da ove odluke predstavljaju izvor prava, odnosno da drugačije odlučivanje od ovih odluka ne znači da postoji odstupanje od sudske prakse; ali (iii) uprkos činjenici da je ocenio da su činjenične i pravne okolnosti bile iste, nije

31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe kishte kthyer çështjen në rivendosje në Gjykatën e Apelit.

Në procedurën e përsëritur, Gjykata e Apelit sërish refuzoi padinë e parashtrueses së kërkesës. Gjykata e Apelit, përmes vendimit të ri, ndër të tjera, kishte theksuar se (i) është e saktë që rasti i parashtrueses së kërkesës dhe rastet e tjera të cilave e njëjta u referohet kanë *“të bëj me rrethana të njëjta faktike dhe juridike”*; dhe (ii) nuk mund të konsiderohet se këto vendime paraqesin burim të së drejtës përkatësisht vendosja ndryshe nga këto vendime nuk do të thotë se ka devijim nga praktika gjyqësore; por (iii) përkundër faktit që kishte vlerësuar se rrethanat faktike dhe juridike ishin të njëjta, nuk kishte arsyetuar, përkundër pretendimeve specifike të parashtrueses së kërkesës, vendimmarrjen ndryshe në rrethanat e rastit të saj; dhe (iv) as nuk kishte adresuar konstatimin kryesor të Aktgjykimit paraprak të Gjykatës, përkatësisht Aktgjykimit KI145/18, se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për trajtim të pabarabartë para gjykatave, ishte thelbësor dhe ngrente çështje nga neni 24 i Kushtetutës, përkatësisht çështjen e pabarazisë së palëve para ligjit

#### *Ankesat e parashtrueses së kërkesës*

Parashtruesja e kërkesës iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shkëlqje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se Gjykata e Apelit në procedurën e përsëritur nuk kishte adresuar konstatimet e Gjykatës Kushtetuese në Aktgjykimin KI145/18.

#### *Gjetjet e Gjykatës*

Gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe të GJEDNJ-së përkitazi me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, dhe më pas aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi që, në procedurën e përsëritur Gjykata e Apelit nuk kishte

obrazložio, uprkos konkretnim navodima podnositeljke zahteva, drugačije odlučivanje u okolnostima njenog slučaja; i (iv) nije razmotrio glavni zaključak prethodne presude Suda, odnosno presude KI145/18, da je navod podnositeljke zahteva o nejednakom tretmanu pred sudovima bio suštinski i pokrenut prema članu 24. Ustava, odnosno pitanje nejednakosti strana pred zakonom.

#### *Žalba podnosioca zahteva*

Osporavajući zaključke Apelacionog suda, podnositeljka zahteva se obratila Ustavnom sudu, navodeći povredu članova 24. i 31. Ustava u vezi sa članom 6. EKLJP-a, zato što Apelacioni sud u ponovljenom postupku nije razmotrio zaključke Ustavnog suda u presudi KI145/18.

#### *Nalazi Suda*

Ocenjujući navode podnositeljke zahteva, Sud je prvo razradio opšta načela svoje sudske prakse i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava u vezi sa obrazloženjem sudskih odluka, a zatim je iste primenio na okolnosti ovog slučaja. S tim u vezi, Sud je utvrdio da se Apelacioni sud u ponovljenom postupku nije osvrnuo na zaključke Suda u presudi KI145/18 i nije ponovo obrazložio drugačije odlučivanje u sličnim činjeničnim i pravnim okolnostima, odnosno nije dao obrazloženje (i) da li je postojao drugačiji tretman i odlučivanje Osnovnog suda u sličnim činjeničnim i pravnim okolnostima; i (ii) ako je odgovor potvrđan, da li postoje razumna opravdanja za takvo odstupanje od sudske prakse.

Sud je, na osnovu svoje konsolidovane sudske prakse i u meri u kojoj je to relevantno za okolnosti ovog slučaja, istakao, između ostalog, da propust da se pruže jasni i potpuni odgovori u vezi sa suštinskim i odlučnim navodima koje je iznela podnositeljka zahteva nije u skladu sa garancijama koje se odnose na pravo na obrazloženu odluku, kao sastavni deo prava na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovanog Ustavom i EKLJP-om.

#### *Zaključak*

adresuar konstatimet e Gjykatës përmes Aktgjykimit 145/18 dhe nuk kishte arsye-tuar sërish vendimmarrjen ndryshe në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, përkatësisht nuk kishte dhënë arsyetim (i) nëse ka pasur trajtim dhe vendimmarrje tjetër të Gjykatës Themelore në rrethanat e ngjashme faktike dhe juridike; dhe (ii) nëse përgjigja është pozitive, a ekzistojnë justifikime të arsyeshme për një devijim të tillë të praktikës gjyqësore.

Gjykata, bazuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ndër tjerash theksoi se, mosdhënia e përgjigjeve të qarta dhe të plota përkitazi me pretendimet thelbësore dhe përcaktuese të ngritura nga parashtruesja e kërkesës, nuk është në përputhje me garancitë që ndërlihen me të drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ-së.

#### *Përfundimi*

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejtat për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, duke e kthyer të njëjtin për rivendosje në Gjykatën e Apelit.

#### *E drejta për një vendim të arsyetuar*

